



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 66

Prishtinë, më 25 maj 2010, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj dhe Nurishahe Hulaj.

Munguan: Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri, Qamile Morina dhe Vezira Emrush.

Të pranishëm: Besim Sllamniku – Shoqata e Onkologëve të Kosovës, Visare Mujko – UNFPA, Agron Gashi – UNICEF, Sami Uka – WHO, Nora Sahatçiu – UNDP, Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Liridon Selmani – KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Diskutimi i Draftdokumentit të propozuar nga UNDP - ja, për gjendjen në shëndetësi,**
3. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se edhe pse Komisioni nuk ka kuorum, dokumenti mund të diskutohet, ndërsa votimi i dokumentit mbetet për mbledhjen e radhës.*

Diskutimi i Draftdokumentit të propozuar nga UNDP - ja, për gjendjen në shëndetësi

Sadik Idriz – Ky dokument është shqyrtuar edhe më parë nga Komisioni, por në këtë takim kemi dashur që t'i kemi edhe komentet e përfaqësuesve të Organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe të Organizatave Joqeveritare, prandaj i falënderojmë për pjesëmarrjen e tyre dhe i mirëpresim komentet dhe sugjerimet, për plotësimin e këtij dokumenti. Ja dhe fjalën fillimisht përfaqësueses së UNDP- së , Nora Sahatçiu, si propozuese të këtij dokumenti.

Nora Sahatçiu – Tha se ky dokument është përgatitur nga eksperti i UNDP, në bashkëpunim me deputetët e Kuvendit të Kosovës, dhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që

merren me shëndetësi. Ky takim është takimi i dytë lidhur me këtë dokument, dhe është pak më i zgjeruar, në mënyrë që të jetë sa më i plotë dhe ta marrë formën përfundimtare. Komentet nga ky takim do të përfshihen në draftin përfundimtar dhe dokumenti do të përfundohet në mbledhjen e radhës.

Sadik Idriz – Tha se Komisioni po bën përpjekje që përmes këtij dokumenti, të bëjë ftesë dhe të deklarohet që shëndetësia, duhet të jetë me prioritet dhe se duhet të ndërmerren hapa në përmirësimin e gjendjes së saj.

Pjesa e parë e dokumentit përfshin deklaratimet e Komisionit, dhe bazueshmërinë në dokumentet relevante, pjesa e dytë është përshkrimi i gjendjes, dhe në fund janë qëndrimet e Komisionit. Hapi diskutimin duke thënë se i mirëpret komentet e tyre.

Rita Hajzeraj – Tha se përmes këtij dokumenti kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë që të ndërmerren masa konkrete që gjendja në shëndetësi të përmirësohet dhe ligjet e miratuara të zbatohen. Një ndër shtyllat që i mungon shëndetësisë është mungesa e ligjit për sigurime shëndetësore, si dhe buxheti shumë i ulët që ndahet për shëndetësinë. Presim që ky dokument të jetë sensibilizues dhe shëndetësia të jetë prioritet i Qeverisë dhe i institucioneve të Kosovës. Mirëpresim edhe komentet nga ky takim.

Agron Gashi - Tha se kjo është një iniciativë shumë e mirë e Komisionit tuaj. I kam disa komente në këtë dokument, të cilat do t'ua dorëzoj me shkrim. Mendoj përgjithësisht është një dokument i mirë. Me rëndësi është bashkëpunimi në mes institucioneve të ndryshme në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës. Si koment i përgjithshëm është që dokumenti të quhet deklaratë e Komisionit, e jo deklaratë e qëndrimeve. Mendoj se teksti i këtij dokumenti duhet të jetë më i qartë edhe më i kuptueshëm, prandaj ka nevojë për disa përmirësime.

Nurishahe Hulaj – Tha se pajtohem që dokumenti ka nevojë për disa përmirësime, në mënyrë që të kemi një dokument sa më të mirë dhe sa më efikas. Roli i Komisionit tonë është që të bëjmë ligje sa më të mira dhe të bëjmë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Sami Uka – Tha se nëse me këtë dokument kërkojmë që shëndetësia të jetë prioritet, atëherë duhet të angazhohemi të gjithë që shëndetësia të bëhet prioritet, sepse deri me tani nuk ka qenë prioritet. Ka qenë prioritet deklarativ, por asnjëherë prioritet praktik. Shëndetësia ka ndikim në të gjitha segmentet e jetës, si në arsim, në ekonomi dhe në të gjitha çështjet, sepse pa një popullatë të shëndoshë, nuk ka as arsim, as ekonomi e as zhvillim.

Kjo të jetë një deklaratë, e cila do të pasqyrojë vullnetin dhe angazhimin e Komisionit, për përmirësimin e gjendjes.

Ky dokument ka nevojë për disa përmirësime, si përmbajtjesore, ashtu edhe gjuhësore, dhe do të bëjmë përpjekje që të gjithë të japim kontributin, që të jetë një dokument sa më i mirë. Mendoj se dokumenti duhet të ndërtohet mbi bazën e kërkesës, e jo të ftesës. Ju duhet të kërkonit fuqishëm që gjendja të ndryshoj.

Besim Sllamniku – Ky dokument ka nevojë të plotësohet, sepse ka shumë definime të pasakta dhe disa statistika të pa përfshira, e sidomos nuk ka bazueshmëri në statistika të sakta. Me rëndësi është që të ndërmarrim masat se si do të gjejmë një zgjidhje për problemet e shtjelluara në këtë dokument. Kosova ende nuk ka shërbim kardiovaskular dhe shërbim onkologjik. Duhet shikuar mundësia e gjetjes së një zgjidhje, për ngritjen e këtyre dy shërbime. Kosova nuk ka të dhëna për numrin e sëmundjeve malinje. Dëshiroj që ky

dokument të mos jetë vetëm dokument deklarativ, por të jetë një dokument i cili do të nxisë marrjen e hapave konkret në tejkalimin e gjendjes.

Visare Mujko – Ky është një dokument i mirë, dhe me disa ndryshime do t'i ketë efektet e veta. Propozoj që dokumentit t'i shtohet edhe përfshirja e gjithë sistemit shëndetësor, e sidomos atij të sistemit paralel në enklava. Gjithashtu fokusi duhet të jetë më i lartë në parandalim, sesa në trajtim. Duhet t'i kushtohet rëndësi edhe edukimit shëndetësor.

Sadik Idriz – Propozoj që në dokument të ceket që sistemi i të dhënave nuk funksionon, nuk ka raportim, e sidomos nuk ka raportim dhe informata të funksionimit nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve të të pranishmëve në këtë takim, u vendos që pas inkorporimit të propozimeve që u dhanë në këtë takim, dhe dërgimit të propozimeve edhe me shkrim, dokumenti i propozuar të miratohet nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 10

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz